



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM
(Nr. _____, datë _____ 2023)

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR DHËNIEN NË
PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR FAMILJEVE DHE
KOMUNITETEVE ME BANIM TË PËRHershëM NË ZONAT RURALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës "c", të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 57, datë 30.4.2020, "Për Pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve dhe rregullave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale.
2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin sipas nenit 3, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet", ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) "Dhënie në përdorim", procesi i kalimit të së drejtës së përdorimit të fondit pyjor tek familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale, për përbushjen e nevojave vetjake, për produkte pyjore dhe jopyjore;
 - b) "BMET", kanë kuptimin sipas ligjit nr.10120, datë 23.4.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore";
 - c) "Kërkues", ka kuptimin e personit, ose familjes dhe komunitetit me banim të përhershëm në zonat rurale, që më vete ose së bashku, paraqesin kërkesën për të marrë në përdorim sipërfaqen e fondit pyjor dhe për të gëzuar frytet që rrjedhin prej tij, në masën që ka nevojë për vete dhe për familjen e tij;
 - c) "Përdorues tradicional", ka kuptimin e personit që e ka përdorur, ruajtur dhe ka kontribuar më herët me punën e tij, në kryerjen e shërbimeve përmirësuese të sipërfaqes pyjore që kërkohet të merret në përdorim, në mënyrë të vazhdueshme.
 - d) "Për nevojat e veta dhe të familjes", ka kuptimin e nevojave të personit me banim të përhershëm në zonat rurale dhe familjes së tij për dru zjarri, lëndë ndërtimi në funksion

të riparimit të banesës personale, gjethë për blegtori, bimë mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore (BMET), etj.

II. KRITERET PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR PËR NEVOJAT E FAMILJEVE DHE KOMUNITETEVE ME BANIM TË PËRHershëM NË ZONAT RURALE

Fondi pyjor kombëtar jepet në përdorim për nevojat vetjake për familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale, këtu e më poshtë "kërkuesi", nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të përdoret vetëm për përbushjen e nevojave vetjake të familjeve dhe komuniteteve me banim të përhershëm në zonat rurale;
- b) të ketë një sipërfaqe jo më pak se 0.5 hektar;
- c) të menaxhohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në planet e mbarështimit, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për pyjet.
- ç) të jetë në njësinë administrative (fshatin) ku ka vendbanimin kërkuesi;
- d) të shfrytëzohet vetëm për plotësimin e nevojave të komunitetit rural për furnizimin me dru zjarri e lëndë ndërtimi për riparimin e banesave ku jetojnë, si dhe për krasitje për gjethë, me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtordinë dhe BMET.

III. RREGULLAT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR PËR NEVOJAT E FAMILJEVE DHE KOMUNITETEVE ME BANIM TË PËRHershëM NË ZONAT RURALE

1. E drejta e përdorimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar i jepet kërkuesit, bazuar në kontratën përkatëse të përdorimit të lidhur me bashkinë, nëse përbushen kriteret e përcaktuara në këtë vendim, si dhe duke marrë në konsideratë edhe respektimin e barazisë gjinore.
2. Me lidhjen e kontratës së përdorimit të sipërfaqes së fondit pyjor, kërkuesi ka detyrimin të zbatojë kushtet e kontratës, të mos ndryshojë destinacionin e përdorimit si dhe të mos zvogëlojë sipërfaqen pyjore të përdorimit.
3. Sipërfaqet që jepen në përdorim shfrytëzohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike të shfrytëzimit të pyjeve.
4. Në rast të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur midis palëve nga kërkuesi, bashkia ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
5. Për dhënien në përdorim të fondit pyjor, prioritet kanë sipërfaqet pyjore të dëmtuara nga zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, ose nga shkaqe të tjera, në përputhje me objektivat e përcaktuar në planet e mbarështimit.

6. Në rastet kur ka më shumë se një kërkues për të njëjtën sipërfaqe pyjore, ka përparësi për dhënien në përdorim:
 - a. kërkuesi, kur ai është kryefamiljar femër;
 - b. familjet me të ardhura më të ulëta ekonomike;
 - c. kërkuesi, kur ai është përdorues tradicional i asaj sipërfaqeje.
7. Kërkuesi paraqet kërkesën me shkrim pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki (në vijim, SPPB). Kërkesa me shkrim dorëzohet pranë SPPB, të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së planifikuar.
8. Kërkesa me shkrim shoqërohet me informacionin e nevojshëm, të përcaktuar sipas formatit të shtojcës 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Afati i dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar është deri në 1 (një) vit nga data e miratimit të saj nga bashkia përkatëse, me të drejtë rinovimi të kontratës së përdorimit.
10. Për bashkitë që nuk arrijnë të përbushin nevojat për dru zjarri për familjet dhe komunitet e tyre, zbatohen rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për pyjet.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi RAMA